



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2 Nr.18 Tiranë,

Tel. 04 2268142; Fax 04 2268141

Nr. 747 Prot.

Tiranë, më 14.12.2016

V E N D I M

Nr. 159, datë 14.12.2016

**“Për përfundimin e procesit të verifikimit në lidhje me zbatimin të vendimit nr.98,
Dt. 29.7.2016, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; neneve 77-97, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 34 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit dhe verifikimit të dokumentacionit të ardhur nga Bashkia Krujë me shkresën nr.3391/2, dt.16.08.2016, në lidhje me zbatimin e vendimit nr.98, dt.29.07.2016 “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit filluar me Urdhrin nr.468/3, dt.17.07.2016”, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

Vërejtje se:

Në zbatim të Urdhrit të Verifikimit nr.468/3, dt.17.07.2016, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me disa parregullsi të konstatuara gjatë procesit të ristrukturimit të Bashkisë Krujë, që kanë të bëjnë me cënimin e marrëdhënies së punësimit të nëpunësit ***** me detyrë Inspektor i Tatim-Taksave në Njësinë Administrative Nikël, është kryer hetimi i plotë administrativ.

Ky proces është përmbyllur me vendimin nr.98, datë 29.07.2016, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit filluar me Urdhrin nr.468/3, dt.17.07.2016”, në të cilin është vendosur:

1. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse, që të drejtojë procesin e rregullimit të ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, duke filluar me revokimin e aktit administrativ të Kryetarit të Bashkisë Krujë, nr. 116 prot., datë 20.10.2015, “Për lirimin nga shërbimi civil”, për punonjësin *****.
2. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse, që të zbatojë procedurën e përcaktuar në nenin 50, pika 3, e vijues, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Vendimit nr. 171, dt. 26.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për transferimin e përhershëm dhe të

përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”, për ta sistemuar punonjësin në një pozicion pune, duke respektuar radhën e mëposhtme të veprimeve:

- Të nxjerë urdhrin për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit;
 - Të monitorojë mënyrën e funksionimit të këtij komisioni dhe hartimin e dokumentacionit e propozimeve që do të përpilohen prej tij, në lidhje me transferimet, rrimërimet dhe lirimet nga shërbimi civil, të punonjësve të institucionit, të cilëve u është shkurtuar apo ristrukturuar pozicioni i punës;
 - Njësia përgjegjëse të nxjerrë aktet përfundimtare nominale për miratimin apo mosmiratimin e propozimeve të Komisionit të Ristrukturimit, duke pasur parasysh respektimin e të drejtave të nëpunësve civilë që lirohen nga shërbimi civil.
3. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse, që në rastin e pamundësisë për sistemimin e punonjësit/punonjësve të cilëve iu është shkurtuar ose ristrukturuar pozicioni i punës, të vendoset përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil, duke treguar kujdes për plotësimin e detyrimeve që rrjedhin prej pikave 7 dhe 8, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, që kanë të bëjnë me dhënien e një shpërblimi në përputhje me vjetërsinë në shërbimin civil dhe mundësinë që brenda një periudhe 2 vjeçare, të konkurrojnë si nëpunës civil për procedurat e lëvizjes paralele, apo ngritjes në detyrë, apo të emërohet në mënyrë të përkohshme, me pëlqimin e tij, në pozicione të shërbimit civil, që lirohen përkohësisht, për shkak sëmundje, leje lindje e arsye të tjera ligjore.
4. Bashkia Krujë, të zbatojë vendimin brenda 15 ditëve nga data e marrjes dijeni dhe pas përfundimit të këtij afati, të njoftojë me shkrim Komisionerin, për zbatimin e vendimit.

Me kalimin e afatit procedural të parashikuar në pikën 4, të Vendimit nr.98, dt.29.07.2016, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Bashkia Krujë me shkresën nr.3391/2, dt.16.08.2016, ka njoftuar Komisionerin në lidhje me zbatimin e vendimit të mësipërm.

Nga verifikimi i dokumenteve bashkëngjitur kësaj shkrese, rezultoi se:

- ✓ Në zbatim të pikës 1 të Vendimit nr. 98, datë 29.07.2016, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Bashkisë Krujë me anë të vendimit nr.28, dt.16.08.2016, ka revokuar aktin administrativ nr.116, dt.20.10.2015, për lirim nga detyra të punonjësit *****.
- ✓ Në zbatim të pikave 2 dhe 3 të vendimit, Drejtoria e Burimeve Njerëzore në cilësinë e njësisë përgjegjëse, në respektim të nenit 50 e vijues të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin Civil”, i ndryshuar si dhe të Vendimit nr. 171, dt. 26.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”, me anë të Vendimit nr.28, dt. 27.07.2016, ka ngritur Komisionin e Ristrukturimit të Bashkisë Krujë dhe Njësive Administrative. Komisioni i Ristrukturimit të Bashkisë Krujë, në pamundësi për sistemimin e punonjësit ***** , të cilit i është shkurtuar pozicioni i punës, me shkresën nr.3518, dt.16.08.2016, i ka propozuar Njësisë Përgjegjëse, lirim nga shërbimi civil dhe sistemimin e punonjësit në listë pritje për një periudhë 2-vjeçare. Drejtoria e Burimeve Njerëzore, bazuar në propozimin e mësipërm, ka nxjerrë Vendimin nr.29, dt.16.8.2016,

me anë të cilit nëpunësi lirohet nga shërbimi civil dhe kalon në listë pritje 2 vjeçare sipas përcaktimeve të pikave 7 dhe 8 të nenit 50 të ligjit nr.152/2013 “Për shërbimin civil”, i ndryshuar .

Sa më sipër, konstatoj se, Vendimi nr.98, datë 29.07.2016 , “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit filluar me Urdhrin nr.468/3, dt.17.07.2016”, është zbatuar në tërësi, nga ana e subjektit, **Bashkia Krujë**.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe në nenin 34 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit nr.98, dt.29.07.2016, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit filluar me Urdhrin nr.468/3, dt.17.07.2016” në institucionin, Bashkia Krujë.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë përgjegjëse, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e Vendimit nr. 98, datë 29.07.2016 ,“Mbi përfundimin e procesit të verifikimit filluar me Urdhrin nr.468/3, dt.17.07.2016”.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni, Bashkia Krujë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA